

MERRNI E HANI...



MERRNI E PINI...

Jeta Liturgjike

Viti I Nr. 6, Gusht 2005



Zoja Cërnagore, - Lutu për ne

Të ngriturit e Zojës në qiell Zoja e Madhe

(15 Gusht 2005)

E vërteta e fesë sonë

Të ngriturit e Zojës në qiell është dogmë mariologjike në Kishën Katolike. Pio XII ditën e të gjithë shenjtërve në vitin 1950, gjatë kremtimit të meshës, në mënyrë solemne „ex cathedra“ ka shpallur: „Me autoritetin e Zotit tonë Jezu Krishtit dhe apostujve të lumë Sh'Pjetrit dhe Sh'Palit dhe autoritetin tim: shpallim, kumtojmë dhe urdhërojmë se Hyjlindsja e pamëkat, Maria gjithmonë virgjër, në fund të jetës së saj tokësore ka qenë e ngritur me trup e më shpirt në lumturinë qiellore!“. Me këtë akt, Pio XII ka shpallur dogmën e re, të katërtën për Zojën e Bekuar. Kjo e vërtetë e fesë sonë ngërthen në vete jo vetëm të vërtetën për Marinë, por edhe të vërtetën për Jezu Krishtin, sepse dëshmon thelbin e fesë, ngjalljen e Jezu Krishtit. Gjithashtu, të Ngriturit e Zojës në qiell, është për ne siguri e gëzueshme dhe shpresëdhënëse, se të bashkur me Zojën në fe dhe lutje, do të ringjallemi për t'u takuar me Krishin e ringjallur në Qiell. Pra, të Ngriturit e Zojës është po ashtu e vërtetë eskatologjike, sepse dëshmon se jeta e njeriut nuk mbaron me vdekje, por ajo rifiton përjetësinë në qiell. Edhe pse në vitin 1950 është shpallur kjo dogmë, Kisha që nga shekujt e parë ka besuar në Ngritjen e Zojës në Qiell me trup e me shpirt. Të krishterët gjithmonë kanë besuar se Nëna e Jezu Krishtit dhe Nëna jonë qiellore, në çastin e vdekjes ka qenë lumturisht e ngritur në qiell te Biri i vet. Kjo Nënë, e cila ia ka dhuruar trupin Birit të Hyjit, Jezu Krishti u mishërua nëpërmjet Marisë - trupi i saj i shenjtë s' do të kalbet nën dhé, por lumturisht do të ngritet pranë Shenjtërueshmes Trini. Kjo e vërtetë nuk është ide e kërve kishtar të shekujve të vonshëm, por ka themelet në Shkrimin Shenjt dhe në traditën e lashtë, shekullore të Kishës. Në Zbulesën e shën Gjonit lexojmë „Në qiell u duk një shenjë e madhërueshme: një Grua e veshur me diell, me hënë nën këmbë, në krye kezën me dymbdhjetë yje!“

(Zb 12, 1). Maria është e veshur me diell, me lavdi dhe shkëlqim hyjnor. Ajo është Gruaja mbi gjitha gratë. E denjë të bëhet mbretëresha e qiellit dhe tokës me kezë dymbdhjetë yjesh.

Përshpirtëria ndaj Virgjërës Mari

Përshpirtëria e katolikëve ndaj Nënës së Jezu Krishtit, Zojës së Bekuar është e lashtë, që nga ditët e para të Kishës. Ajo përherë, deri në ditët tona, ka zënë një vend krejt të posaçëm në lutjet e besimtarëve dhe përshpirtërinë e gjithëmbarshme kishtarë, që nga Papët e Romës (Papa Gjon Pali II, krejt papatin e vet ia besoi Marisë me fjalët - moton: Totus tuus krejt i yti), ipeshkvijtë, meshtarët e deri te besimtari më i thjeshtë, sepse devocioni i vërtetë për Nënë e Zotit është në të vërtetë devocion kristocentrik dhe është i rrënjosur shumë thellë në misterin e Trinisë Shenjte, si dhe në misterin e Mishërimit. Nuk është e tepërt të thuhet se Maria e ka merituar një nderim dhe devocion kaq të madh, për arsye se Ajo ëshë personi kyq në historinë e shëlbimit, që ka pranuar ardhjen e Shëlbuesit. Të kujtojmë „PO“-në e saj të guximshme dhe plotë fe, për ta lindur më fuqinë e Shpirtit Shenjt Fjalën e Hyjit. Po-ja e saj ishte akti vendimtar dhe akti pranimit për të filluar epoka e re njerëzore. Ajo ka lejuar të jetë Grua, e cila krejtësisht dorëzohet në shërbim të Fjalës. Trinia Shenjte ka ngritur përmes Marisë shatorin e vet për të qënë Emanuel-Zoti me ne. Maria u bë shator - tendë hyjnore, ku banon Hyji i gjallë, që përmes saj të mund të realizohet plani i amshuar i Atit; përmes Saj të mund ta takojë përsëri njeriun e rënë dhe të humbur në shkretëtirën e botës. Këtë të vërtetë bibliko-teologjike besimtarët e krishterë përherë e kanë ushqyer me një nderim të lartë me përshpirtëri të thjeshtë dhe spontane, duke i thurur asaj vargje urate e poezie, që sot luten në gjithë botën më shumë përkushti dhe dashuri. Mandej, nuk mund të paramendohet përshpirtëria e një katoliku pa lutjen, përshpirtërinë, devocionin dhe përkushtinë ndaj Nënës Qiellore, Zojës së Bekuar. Zoja është bërë Nënë e të gjithëve, Nënë për të pleqë e plaka, të rinj e të reja. Ajo

është bërë shembull ndjekës për të krishterët e të gjitha kohërave, sa i përketë besimit, shërbimit, dhurimit etj.. Ajo është siguria jonë, sepse në qiell nuk pushon të ndërmjetësojë te Birin i vet për ne.

Zoja Cërnagore - Shenjtërorja e Zojës në Letnicë

Për çdo vit kur vjenë 15 gushti, në besimtarët e Kosovës në mënyrë krejt natyrore e kujtojmë Zojën e Madhe apo Zojën Cërnagore. S'ka besimtar, që nuk ka dëgjuar për shënjtëroren e Zojës Cërnagore në Letnicë, ndërsa shumica e tyre edhe ka shtegtuar te ajo. Sepse përshtpirtërinë dhe lutjet më të mëdha që besimtarët tanë ia drejtojnë Nënës qiellore, i bëjnë në këtë shënjtërore të ipeshkvisë sonë. Ky vend i shënjtë tërhjek mijëra besimtarë nga të gjitha viset e Kosovës.

Na kujtohen në këtë rast shtegëtimet tradicionale, bësimitarë të shumtë këmbëzbathur më qindra kilometra që shtegëtonin të pa lodhshëm për t'u takuar me Nënë. Kjo traditë e kahmotshme është e pranishme edhe në ditët tona. Aty është krijuar një përshtpirtëri e thjeshtë dhe e sinqertë mariane. Për çdo vitë organizohen nëntëditshë dhe triditëshë të shoqëruara me meshë dhe pretke kushtuar Zojës; lutja e rruzarares në bashkësi dhe individuale, organizimi i procesionit me turporen e Zojës, si nderim dhe besim publik ndaj Saj, e shumë përshtpirtëri tjera, që besimtarët në mënyra të veta i drejtohen Zojës.

Në shënjtërore, përpos katolikëve, hasim edhe njerëz të besimeve të tjera, ortodoksë e myslimanë, të ardhur nga vise të ndryshme. Është mrekulli e këndshme se si Zoja i bashkon njerëzit e të gjitha racave dhe konfesioneve rreth Birit të vet, Jezu Krishtit. Prandaj, Zojën Cërnagore mund ta thërrasim me plotë gojë Nëna e bashkimit, Nëna ekumenike, Nëna e dialogut. Ajo me butësi e dashuri i përkdhel të gjithë, i mëson me pedagogjinë e saj të mrekullushme amnore, se

të gjithë njerëzit janë vëllezër e motra, janë bijë e bija të një Ati dhe një Nëne.

Sot në mesin tonë të brishtë e të luhatshtëm (kosovar) kemi nevojë për një pedagogji të Zojës, të na mësojë të duhemi mes veti, të na mësojë të dimë të krijojmë shpirt të paqes dhe dashurisë ndërnjerëzore dhe ndërftare, të na mësojë të jemi kultivues të një qytetërimi të dashurisë, sepse ku s'ka dashuri amnore, mariane, aty shumë lehtë do të zotërojë dhuna, forca, ideologjitë pushtetëmarrëse dhe lufta. Papa i sotshëm Benedikti XVI, në librin intervistë me gazetarin italian Vittorio Messori, ka shprehur qartë se Maria, Nëna Qiellore „duhet të ketë rolin e baraspeshimit në fe. Sot, më tepër se asnjëherë në historinë e Kishës, duhet ta pranojmë rolin e saj“. Dhe vazhdon: „Është i nevojshëm kthimi te Maria, nëse dëshirojmë të kthehemi në të vërtetën mbi Jezusin, Kishën dhe njeriun“.

Në këtë kontinuitet, edhe ipeshkvijtë tanë me shekuj, që kur ekziston kjo shënjtërore, kanë kërkuar nga besimtarët dhe njerëzit vullnetmirë, të shtegëtojnë te Zoja Cërnagore për ta lutur Nënë Qiellore për nëvoja tona shpirtërore dhe trupore, për Kishën tonë dhe për paqe në vendin tonë. Nga tradita e lashtë e kësaj shënjtërore dhe trupores së Zojës, kemi dëshmi të shumta se Zoja ka plotësuar dëshira dhe lutje të shumta. Ka dëshmitarë të shumtë që tregojnë se me qindra njerëz shtegëtarë kanë gjetur te kjo Zojë Nënë, që i plotëson lutjet e tyre dhe janë kthyer në vendet e veta me qetësi shpirtërore, të penduar, madje edhe me kthim kah Jezu Krishti. Kjo tregon se, Zoja e Bekuar është rruga që të çonë te Jezusi, që të tregon dhe të udhëheqë kah qielli, ku ajo e gëzon lumninë e pasosur bashkë me Birin e vet, me engjëj dhe shënjtër. Mos ta harrojmë Zojën, të shkojmë edhe ne atje, që ta përjetojmë dashurinë e Nënës, butësinë e përqafimit të saj amnor dhe ta dëgjojmë fjalën e saj të ëmbël. Zoja Cërnagore lutu për ne!

Don Fatmir KOLIQI

E DIELA E XIX gjatë vitit

...jam unë. mos kini frikë! Më shpëto, o Zot!

Leximi i parë: *1 Mbr 19, 9. 11-13* Elia largohet nga mbretëresha Izabela, që dëshiron vdekjen e tij, dhe arrinë në malin Horeb, ku Zoti i kishte folur Moisiut. Elia sikurse Moisiu ka një përvojë të Zotit. Zoti shfaqet nga një erë e lehtë, që simbolizon intimitetin e dashurisë në takim me Zotin, që është i tëri vetëm bamirësi dhe mëshirë.

Psalmi 85 (84): *Na e jep, o Zot, paqen e pranisë sate.*

Leximi i dytë: *Rom 9, 1 -55* Shë n Pali, i trishtuar në shpirt, flet për shpëtimin, që na e solli Krishti. Populli i Izrealit, prej të cillit si njeri erdhi edhe vet Krishti, me fajin e vet largohet prej këtij shëlbimi. Pali është i gatshëm ta flijojë vetveten, vetëm e vetëm për ta shpëtuar kombin e vet Izraelin

Ungjilli: *Mt 14, 22-33*

Pasi që e ngiu turmën Jezusi u urdhëroi nxënësve të hyjnë në barkë e të kalojnë para tij në anën tjetër derisa ai ta shpërndajë popullin. Jezusi, si nisi popullin, u ngjiti vetëm në mal për t'u lutur. Ishte bërë natë e ai ende gjendej aty vetëm. Barka, që tashmë ishte shumë stadje larg tokës, përplasej prej valesh, sepse frynte era e kundërt. Në rojën e katërt të natës erdhi Jezusi tek ata duke ecur përmbi det. Kur nxënësit e hetuan duke ecur përmbi det, u frikësuan e thanë. "Diçka po na shtiret!" e prej frikës bërtitën. Por, menjëherë Jezusi u tha: "Zemër, jam unë, mos kini frikë!" Pjetri përgjigji: "Zotëri, nëse je ti, më urdhëro të vij te ti përmbi ujë!" "Eja!" i tha. Atëherë Pjetri zbriti nga barka e po ecte nëpër ujë për të shkuar te Jezusi. Porse, kur e pa erën e fortë, u frikësua, filloi të humbasë në ujë dhe bërtiti: "Më shpëto, o Zot!" Jezusi përnjëherë shtriu dorën, e kapi dhe i tha: "Fepakët! Përse dyshove!" Kur hynë në barkë, pushoi era. Ata që ishin në barkë u përkulën me nderim para tij e thanë: "Me të vërtetë je Biri i Hyjit!"

Fjala e Zotit

Shumë herë ungjilli na paraqet Jezusin dhe personazhet tjera të Biblës në lutje. Lutja është momenti i dialogut të hareshëm dhe të besimit me Zotin. Është momenti i takimit me një Atë që të do. Por gabojmë nëse mendojmë që lutja duhet të bëhet vetëm në raste të qetësisë, kur të gjitha gjërat i kemi në rregull. Sot kemi dëgjuar se çfarë i ka ndodhur profetit Eli. Elia është duke ikur nga mbretëresha, që ia dëshiron vdekjen. Ikën në shkretëtirë ku pa bukë dhe ujë ndjehet afër dyerve të vdekjes. Por në këtë moment i lutet Zotit. Duhet të mësojmë të lusim Zotin në çdo rrethanë të jetës, kur të gjitha gjërat i kemi në rregull, apo kur është errët dhe errësirë e plotë; kur kemi probleme të rënda.

E qartë është që lutja na nevojitet si ndihmë për problemet tona, por diçka edhe më tepër se kjo. Lutja na bën të njohim Zotin më mirë. Elia duhet të njeh Zotin në frymën që kënaq shpirtin. Zoti nuk është në dhunë, nuk është në zjarrë apo në fuqitë e natyrës. Zoti është i ndryshëm, është një Person, një Person hyjnor. Edhe ne mund të njohim më mirë Zotin kur lutemi. Ndonjëherë na duket se Zoti është larg nesh, që nuk na flet, që nuk na dëgjon. Por mund të ndodh që ne jemi ata që ia kemi mbyllur zemrën Zotit: E Zoti jeton



në zemrat tona dhe pret që ne t'i flasim. Por kemi shumë punë, shumë gjëra që na bezdisin. Mendja dhe zemra jonë nuk gjejnë kohë për Jezusin. Sigurisht që gjejmë kohë për momente të tjera të pushimit. Duhet të kuptojmë që këtë të diele, takimi personal me Zotin është me rëndësi jetike për secilin prej nesh; ne nuk mund të jemi të krishterë të vërtetë pa lutje. Në ungjill shohim se si Jezusi dominon në të gjitha. Natyra është shërbëtorja e tij dhe ajo e zbaton urdhërin. Natyra është edhe shoqëria jonë ku ndonjëherë na duket që është armiku ynë. Ka shumë rreziqe dhe shumë probleme për të jetuar si të krishterë. Sikurse apostujve, deti i jetës na duket që nuk është i lehtë dhe që jeta jonë mund të fundoset. Përkundrazi disa herë kemi vepruar sikur Pjetri dhe dëshirojmë të veprojmë vet, të tregojmë që mundemi të fitojmë detin me aftësitë tona. Mirëpo uji dhe jeta duken pak solide. Duket që deti është më i fortë se ne: sikur Pjetri ndjejmë dëshirën për të bërtitur “Më ndihmo, o Zot”. Sot mund të themi i bekuar rreziku dhe i bekuar problemi, kuptohet se kemi nevojë për Zotin dhe që nuk mund të fitojmë të keqen vetëm, që kemi nevojë për lutje të sinqertë. Duhet të ndjehemi të varfër, të përvojatur pranë Zotit, sikurse apostujt. Dëgjojmë zërin e Jezusit: “Mos kini frikë”. Është e njejta porosi si e Papës Gjon Palit II: “Hapni zemrën e juaj Krishtit, mos kini frikë.” E njejta porosi edhe e Papës Benediktit XVI drejtuar të rinjëve në ditën e parë të papatit të tij: “Mos kini frikë nga Krishti. Krishti nuk heq asgjë të mirë nga jeta. Përkundrazi Krishti dhuron përparësi gjithë asaj që me të vërtetë është njerëzore.” Sikur Pjetri, sot, këtë javë t'i lutemi edhe ne me sinqeritet Jezusit, duke folur me te për problemet dhe nevojat tona: *Jezus, eja tek ne, na ndihmo në dobësitë tona, mos na lë të vetmuar. Barka e kishës sonë, barka e jetës*

sonë, duket se është në rrezik. Na ndihmo!

Jemi të sigurt që me fuqinë e Jezusit mund ta mposhtim të keqen dhe problemet. Fjala e Jezusit arrin në jetën tonë dhe dhuron qetësi për të jetuar në paqe dhe besim të plotë në duart e Tij. Amen.

Lutja e besimtarëve

Vëllezër dhe motra, ta lusim Atin tonë qiellor, të na ndihmojë në përditshmërinë tonë, duke thënë: *Na dëgjo, o Zot.*

- Për Kishën Katolike, e cila si një anije e madhe lundron në detin e trazuar, udhëheqje, ruaje dhe ndihmoje, *të lutemi.*

- Për Papën dhe barinj të Kishës: që mos të lejojnë të fiton mosbesimi apo frika, duke pasur tërësisht vetëm besimin në praninë e Krishtit, që të dijnë të ngjallin fenë, shpresën dhe dashurinë, *të lutemi.*

- Për ata që janë të dobët në fe, shtojau fenë, dhe bëj që ta sprovonjë afërsinë tënde, o Zot, *të lutemi.*

- Për të gjithë të sëmurët, të varfërit, të moshuarit, *të lutemi.*

- Për të gjithë ne, që dëgjojmë ungjillin për çdo të diele, që të dijmë të jetojmë në përkim me të, *të lutemi.*

- Për familjet tona, dhe për familjet e gjithë botës, që me ndihmën tënde të gjejnë lumturinë dhe paqen në jetën e tyre, *të lutemi.*

Na lejo, Zot Ati ynë, që të dimë të njohim me sytë e fesë sonë, këtu në tokë, që një ditë në Mbretërinë tënde të shohim sy me sy. Nëpër Krishtin Zotin tonë. Amen.

Don Javier SANZ SDB

E DIELA E XX gjatë vitit

Më ndihmo, o Zot! O grua, e madhe është feja e jote!

Leximi i parë: *Is 56, 1. 6-7* Zoti nëpërmjet Izaisë profet na këshillonë të mbajmë të drejtën e të zbatojmë drejtësinë, sepse shëlbimi është duke ardhur e s'vonon të dëftohet drejtësia e tij.

Psalmi: *67 (66) Të dhënçin lavdi mbarë popujt, o Hyj.*

Leximi i dytë: *Rom 11, 3-15. 29-32* Dhurata dhe thirrja e Zotit, siç na mëson shën Pali nuk tërhiqen. Të gjithë jemi të ftuar të jetojmë sipas urdhërimeve të Zotit, për të fituar mëshirën e Tij, shëlbimin.

Ungjilli: *Mt 15,21-28*

Në atë kohë, Jezusi, doli prej atij vendi e kaloi në krahinat e Tirit e të Sidonit. Dhe, ja një grua nga Kananeja, që kishte ardhur nga ato anë, filloi të bërtasë e të thotë. "Ki mëshirë për mua, o Zot, Biri i Davidit! Djalli po ma mundon tepër vajzën!" Por ai nuk i përgjigji fare. Atëherë iu afruan nxënësit e tij e i thanë: "Bëja këtë nderë e të shkojë, sepse po bërtet pas nesh!" Ai u përgjigji: "Unë jam i dërguar vetëm te delet e humbura të shtëpisë së Izraelit." Por ajo u afrua, u përkul thellë në nderim para tij e tha: "Më ndihmo, o Zot!" Jezusi i përgjigji: "Nuk është mirë të marrësh bukën e fëmijëve e t'ua qesësh këlyshve të qenve." "Po, o Zot, - shtoi ajo - edhe këlyshët hanë dromcat që bien nga tryeza e zotërinjve të tyre." Atëherë Jezusi i përgjigji: "O grua, e madhe është feja jote! Le të bëhet ashtu si dëshiron!" Në atë moment u shërua bija e saj.

Fjala e Zotit

Në ungjillin e sotshëm Krishtin e takojmë në Tir e Sidon, qytete të banuara me pagan, ku kishte pak izraelitë. Dhe derisa kalon rrugës me apostujt, një grua kananeje, pagane, që kishte dëgjuar për Krishtin, kërkon prej Tij për t'ia shëruar vajzën. Mos ta përsërisim ngjarjen, por le të mundohemi të nxjerrim porosinë prej kësaj pjese të ungjillit. Krishti duke e parë besimin e saj të madh, e lavderon atë dhe ia shëron vajzën, pra, ia plotëson dëshirën.

Ju, si prindër, a jeni të kujdesëshëm si kjo nënë për bijën e vet? A e dini çka e mundon fëmijun tuaj, me çka brengoset dhe ngarkohet? Ku dhe me kënd e kalon kohën e lirë? Nëse vuan nga ndonjë sëmundje, ku kërkon shërimin? A thua nuk ndodh që prindërit katolikë të kërkojnë ndihmë edhe tek fallqorët?

Krishti vërtet erdhi për t'i sjellur shëlbimin Izraelit, dhe Ai shumë rrallë është larguar nga Palestina, gjegjësisht në Galile dhe Samari, ku kishte edhe paganë, jo izraelitë, që e pranuan mësimin e Tij. Për këtë arsye Krishti në një vend thotë: *Imjerti ti, Korazin, e mjera ti, o Betsaidë! Sepse, sikur të ishin bërë të gjitha ato mrekulli në Tir e në Sidon, që u bënë ndër ju, që kaheër do të kishin bërë pendesë... / Krh. Mt 11, 24/.* Pra, Krishti ju thotë, sikur të kishin ndodhur në qytetet tjera pagane mrekullitë që kanë ndodhur në këto qytete afër liqenit të Tiberiadit, sigurisht shumë më tepër paganë kishin për ta përqaftuar besimin e krishterë.

Krishti vajton edhe mbi Jerusalemin: *Jerusalem, vrastar i profetëve..., sa herë desha t'i bashkoj fëmijët tu sikurse këlluka i bashkon zogjtë e*

vet nën krahë... por ju nuk deshët! / Krh. Mt 23, 37/. Pra, izraelitët mbetën zemër guri ndaj mësimëve të Krishtit. Për ta vlen fjala e Krishti: *Vesh kanë e nuk dëgjojnë, sy kanë e nuk shohin!*

Krishti në ungjillin e sotshëm dëshmon se qëllimi i ardhjes së Tij në botë ishte t'i mbledhë e t'i shpëtojë delet e humbura të Izraelit, por nuk pati shumë sukses. Mjerisht udhëheqësit e Izraelit, farisenjtë e saducenjtë, duke manipuluar me popullin kërkuan vdekjen e Krishtit. Por pas predikimit të apostujve, pas ringjalljes së Krishtit, numëri i izraelitëve që pranuan krishtërimin rritej gjithnjë, edhe pse me vështërsi. Por edhe këtu më të gatshëm për ta pranuar Lajmin e Gëzueshëm ishin paganët. Problemi lindi kur disa nga apostujt mendonin se atyre duhet imponuar ligjin hebrenj, pra, atë të Izraelit. Për të zgjidhur sa më mirë këtë problem, u mblidhën në Jerusalem të gjithë apostujt në krye me Pjetrin, papën e parë. Aty pas bisedimeve të shumëta u vendos që paganëve të mos iu imponohen ligjet hebreje / Lexo: Vap 15, 1-21/.

Mund të themi se ky është problemi edhe i misionarëve sot: A duhet, pra, popujve apo fiseve të ndryshme të botës si p, sh. në Afrikë, në Azi etj. t'iu imponohet kultura evropiane bashkë me besimin e krishterë? Natyrisht se jo. Të gjithë popujt duhet të mbajnë kulturën dhe traditën e vet, kuptohet, nëse nuk është në kundërshtim me besimin e krishterë. Në Kishën Katolike nuk ka dallim race, kombi apo gjuhe, i pasur apo i varfër, skllav apo i lirë, sepse të gjithë jemi dhe duhet të jemi një në Krishtin, si na mëson edhe vet shën Pali, si ka dëshmuar e Lumëja Nëna jonë Tereze. Amen.

Lutja e besimtarëve

Me shpresë se Jezusi, sikur që e dëgjoji lutjen e gruas nga ungjilli i sotshëm, do t'i dëgjojë edhe lutjet tona, le t'i themi:

- Për Kishën tënde, që të jetë si një shtëpi për t'i pranuar të gjithë ata që dëshirojnë të hyjnë në të, sidomos të varfërit, të sëmuret, *të lutemi.*

- Për misionarët, që me ndihmën Tënde me sukses t'iu sjellin popujve Lajmin Tënd të paqes dhe të dashurisë, *të lutemi.*

- Për gjithë katolikët anëkend botës, që duke e jetuar besimin e vet të kontribuojnë në paqen dhe mirëqenjen e botës, *të lutemi.*

O Ati ynë qiellor, ne nuk dijmë si të lutemi, por nepërmjet Birit tënd t'i drejtuam këto lutje me fe, shpresë dhe dashuri. Le të realizohet në jetën tonë plani yt. Nepër Krishtin Zotin tonë. Amen.

Don Jakë PRENKU



E DIELA E XXI gjatë vitit

Ti je Pjetër e ty do t'i jap çelësat e Mbretërisë së qiellit

Leximi i parë: *Is 22, 19-23* Na flet për një ngjarje konkrete, kur nga detyra u largua Sebna, e në vend të tij erdhi Eliakimi. Ishte traditë që si shenjë e pushtetit t'i barte çelësat në krah. Ka ngajshmëri me shën Pjetrin të cilit Krishti do t'ia premton çelësat e Mbretërisë së Hyjit.

Psalmi 138 (137) *Mos na braktis, o Zot...;*

Leximi i dytë: *Rom 11, 33-36:* Ky lexim na dëshmon edhe një herë besimin e fortë dhe të thellë të shën Palit. Ai në këtë mënyrë dëshmon meditimin e tij mbi planin e Zotit në shëlbimin e njerëzimit.

Ungjilli *Mt 16, 13-20*

Në atë kohë, kur Jezusi arriti në krahinën e Cezaresë së Filipit, i pyeti nxënësit e vet: "Ç'thonë njerëzit, kush është Biri i njeriut?" Ata përgjigjën: "Disa thonë se është Gjon Pagëzuesi; do të tjerë Elia; do të tjerë Jeremia ose një ndër profetë." "Po ju, u tha atyre ç'thoni: kush jam unë? I përgjigji Simon Pjetri: "Ti je Mesia Biri i Hyjit të gjallë!" Atëherë Jezusi i tha: "I lumi ti, o Simon, biri i Jonës, sepse këtë nuk ta zbuloi mishi e gjaku, por Ati im që është në qiell! Edhe unë po të them: Ti je Pjetër Shkëmb dhe mbi këtë shkëmb unë do ta ndërtoj Kishën time dhe dyert e ferrit s'do të ngadhënjëjnë kundër saj! Ty do t'i jap çelësat e Mbretërisë së qiellit: gjithçka të lidhësh mbi tokë, do të jetë e zgjidhur edhe në qiell." Atëherë u urdhëroi nxënëset që të mos i tregojnë askujt se është Mesia.


Fjala e Zotit

Zakonisht jemi ne që pyesim Jezusin: Kush je ti? Pra, vazhdimisht pyesim kush është Jezusi? Por, në ungjillin e sotshëm është Jezusi, ai vetë që na pyet, si i ka pyetur apostujt e tij: *Po ju, kush*

mendoni se jam unë? Krishti nuk dëshiron që ne t'i tregojmë se çka të tjerët mendojnë për Të, por çka ne mendojmë dhe themi për Të. Jezusi dëshiron që ne ta njohim Atë, jo të kemi ide të gabuar siq mund ta kenë të tjerët. Për ta kuptuar se kush është Krishti, duhet të pranojmë dhe të bartim kryqin e tij për çdo ditë. Krishti sot na merr në pyetje: *Kush jam unë?* E ne çka do t'i përgjigjemi? Edhe ne mund t'i bëjmë pyetje atij: *E ne, o Jezu, kush jemi? Ju jeni apostujt e mi, do ta dëgjojmë përgjigjen e tij. Ju jeni ata që më ndiqni në rrugën e vuajtjes dhe të vdekjes, duke bartur kryqin.* Por, kjo është rruga që na sjell shpëtimin e përjetshëm, atyre që e pranojnë kryqin për dashurinë ndaj Krishtit. Të vishesh me Krishtin do të thotë të bëhesh një Krisht tjetër, të pranosh vuajtjet e tij, të bartish kryqin e tij. Është nder të jesh një *Krisht tjetër!* Vuajtjet e Krishtit kishin një qëllim: Krishti ka fituar lavdinë e Hyjit Atë për ne. Kështu edhe për ne vuajtjet kanë një qëllim: nëpërmjet tyre pastrohemi nga mëkatet tona, shprehim dashurinë tonë ndaj Zotit, dhe shpallim fenë tonë. Kryqi është rruga e sigurt për të fituar lavdinë e përjetshme.

Çka thonë njerëzit kush është Biri i njeriut? Ka pasur atëherë, por ka edhe sot përgjigje të ndryshme. Disa kanë menduar se Mesia do të jetë një poltikan sundimtar, krijues i perandorisë. Kështu të tillët mendonin se Mesia me shpatë në dorë do të formojë mbretërinë e re në Izrael, edhe më të fortë se Mbretëria e Davidit. Mu për këtë arsye ata e refuzojnë Mesinë, që erdhi për të shërbyer... Mesinë që si kusht për të hyrë në Mbretërinë e tij, kërkon ndërrimin e mënyrës së jetës. Njerëzit edhe sot presin nga Krishti që t'iu plotësojë dëshirat në çdo

sferë të jetës, përndryshe e humbasin besimin në Të! Por edhe pse me vështërsi, apostujt ngadalë binden në mësimin e Tij, dhe e pranojnë Mesinë si të tillë. Bashkë me apostujt numri i atyre që i besojnë këtij Mesie, rritet gjithnjë e më shumë. Le të theksojmë me këtë rast se të gjithë sundimtarët e rinj sollën me vete shumë dhunë, derdhën shumë gjak, duke shkaktuar plagë të pashërueshme, tmerre e mjerim! Krishti, si sundimtar i ri, dëshmon se duhet ndjekur një rrugë të re, deri atëherë të paparë dhe të padëgjuar. Rruga e tij nuk është rrugë e tmerrit dhe dhunës. Në Rrugën e tij janë të ftuar të gjithë



pa dallim. Dhe Ai vetë vdes që të gjithë që besojnë në Të, ta kenë jetën, edhe, atë me plotësi. Kështu dëshmohet dashuria që mund ta ketë dikush: *Nëse e jep jetën për të tjerët*. Këtë e bëri Krishti për ne. Dashuria e Tij ndaj njerëzimit është gurëthemeli i Mbretërisë së Zotit. Për ne si besimtarë është me rëndësi jetike ky fakt: të tjerët, që ende nuk besojnë në Krishtin, duke parë veprat tona të mira, jetën tonë të ndershme, të flasin mirë për ne, Krishtin, Kishën Katolike.

Ti je Mesia, Biri i Hyjit të gjallë! Besimi i krishterë pohon se Jezusi është Hyj i vërtetë dhe njeri i vërtetë, do të thotë që Jezusi ka dy natyra: natyrën njerëzore dhe natyrën hyjnore. Shumë njerëz nuk e mohojnë Krishtin si person historik. Për më tepër shumë prej tyre e çmojnë si njeri të përsosur, të shenjtë, si profet etj. Por nuk e pranojnë si Biri i Zotit apo si Zot. Nëse ne e mohojmë hyjninë e Krishtit, ne atëherë e rrënojmë krishtërimin. Nëse Jezu Krishti nuk është Zot, besimi ynë në të nuk ka kuptim. Gjithë Besëlidhja e Re është një dëshmi se Jezu Krishti është Zot. Ja disa

dëshmi: *“Në fillim ishte Fjala, e Fjala ishte në Hyjin, e Fjala ishte Hyj!”* (Gjn 1,1). *“Unë dhe Ati jemi një!”* (Gjn 10,30); *“Kush më ka parë mua ka parë edhe Atin”* (Gjn 14,9); *“..që të besoni se Jezu Krishti është Mesia, Biri i Hyjit, dhe që duke besuar ta keni jetën në Emrin e tij.”* (Gjn 20,31).

Pra, besimtarë të dashur, besimin tonë në Krishtin Njeri dhe Zot le ta dëshmojmë, sikurse apostujt, me fjalë dhe me vepra. Amen.

Lutja e besimtarëve

T'i përgatisim zemrat tona për pajtim me Zotin dhe me të afërmin, sidomos me ata të cilët i kemi fyer me fjalë apo me vepra, duke thënë: *Na fal ne, o Zot*

- O Zot, fjala jote është për ne burim gëzimi, pajtimi dhe jete. Na fal për pakujdesinë tonë në Kishë, familje dhe gjetiu, *të lutemi.*

- O Zot, Ti dëshiron që të gjithë njerëzit të jetojnë në paqe dhe dashuri. Na fal ngatresat, përçarjet, fyerjet që ia kemi shkaktuar njëri tjetrit, *të lutemi.*

- Çdo e mirë, o Zot, vjen prej teje, ne shpesh herë jemi të pafalënderueshëm ndaj Teje, prindërve dhe të afërmëve, na fal për pakujdesinë dhe mos falënderimin tonë, *të lutemi.*

- O Zot, Ti na ke ftuar të ndjekim Ty në rrugën e kryqit, kështu që së bashku të ringjallemi me Ty. Ne ju kemi shmangur flijimit, kryqit, vuajtjes edhe më të vogël. Pra, po *të lutemi:*

O Zot i mirë, fali mëkatet, lëshimet dhe dobësitë tona dhe na ndihmo që kurrë të mos ndahemi prej Teje. Ti që jeton e mbretëron përgjithmonë e jetës. Amen.

Don Tomë KARRICA

A e dini se....

- Sa ka katolik në botë?

Sipas vjetorit papnor për v. 2003. ja disa të dhëna mbi numrin e katolikëve në botë. Derisa në v. 1978 ishin 757 milion katolik në botë, në v. 2001. ishin 1061. milion. Vetëm në Afrikë numri u rrit në 148 përqind. Gjithashtu numri besimtarëve u rrit edhe në Azi, Amerik, Oqeani. Gjithashtu është rritur edhe numri i meshtarëve prej 110,583 të v. të kaluar në 112,244 çka do të thotë 1,5 përqind.

- Përse nuset veshin fustan të bardhë?

Qysh në kohë të lashta është konsideruar se ngjyra e bardhë është ngjyrë e pastërtisë dhe e virgjërisë. Kjo është ngjyra më e mirë për një vajzë që do të martohet. Fustanet e tilla të bardha quhën fustane të nusërisë. Njerëzit gjithmonë u japin rëndësi ngjyrave. Po thuaj, secila ngjyrë simbolizon diçka, por jo tek të gjithë popujt njësoj. Për shembull, nëse në Evropë ngjyra e bardhë është ngjyrë e pastërtisë dhe e virgjërisë, në Kinë kjo shënon simbol të pikëllimit për dikënd të afërt që të ka vdekur. Te ne adeti që nusja të këtë fustan të bardhë rrjedh që nga Mesjeta si një rit fetar i krishterë. Sot, ka mbetur vetëm si një adet që e shfrytëzojnë të gjithë, pavarësisht se cilës fe i përkasin.

- Çfarë ngjyre ka drita e diellit?

Drita e diellit na duket pa ngjyrë ose e bardhë, por në të vërtetë atë e përbejnë këto ngjyra kryesore: e kuqe, e portokallët, e verdhë, e blertë, e kaltërt dhe vjollce. Këtë mund ta vërejmë, kur një ditë me diell bie shi, drita e diellit thyhet nga pikat e shiut dhe kështu krijohet ylberi.

D.A.D.

E DIELA E XXII gjatë vitit

Nëse ndokush do të vijë pas meje, le ta mohojë vetveten

Leximi i parë: *Jer 20,7-9:* Kur ka qenë lehtë për njerëzit e Zotit, profetët, meshtarët në këtë botë? Kurrë! Këtë e përjeton edhe Jeremia profet, i cili dëshprohet pse nuk e dëgjojnë fjalën e Zotit as ata që medoemos duhet ta pranojnë!

Psalmi 63 (62) *Shpirti im ka etje për ty, o Zot*

Leximi i dytë: *Rom 12, 1-2:* Leximi i shën Palit shumë i shkurtër por me porosi të madhe edhe për ne. Fatëkeqësisht shumë besimtarë tanë gjithnjë e më tepër po jetojnë vetëm sipas parimeve të këtij shekulli.

Ungjilli *Mt 16, 21-27*

Në atë kohë, Jezusi filloi t'u dëftojë nxënësve të vet se i duhej të shkonte në Jerusalem, të vuante shumë prej anës së pleqve, të kryepriiftërinjve e të skribëve, se

do ta vrasin e të tretën ditë do të ngjallet. Atëherë Pjetri e ndau veçmas e filloi ta qortojojë: “Mos e thashtë Zoti, Zotëri! Ty s'do të ndodhë një gjë e tillë!” Jezusi u kthye kah Pjetri e i tha: “Shporru prej meje, he djallë! Je shkandull për mua, sepse nuk i ke në mend punët e Hyjit, por punët e njerëzve!” Atëherë Jezusi u tha nxënësve të vet: “Nëse ndokush do të vijë pas meje, le ta mohojë vetvetën, le ta marrë kryqin e vet e le të vijë pas meje! Sepse, kush do ta ruajë jetën e vet, do ta bjerrë, kurse ai që e bjerr për shkak timin, do ta gjëjë. Ç'dobi ka njeriu nëse e fiton mbarë botën, por e humb jetën? E çka mund të japë njeriu si shkëmbim për jetën e vet? Do të vijë, për të vërtetë, Biri i njeriut në lavdinë e Atit të vet bashkë me engjëjt e vet dhe atëherë do t'i paguajë të gjithë sipas veprave të tyre.”

Fjala e Zotit



Dëgjuam sot psalmistin i cili thotë: *Shpirti im ka etje për ty, o Zot!* Nuk dyshoj që në mesin tonë ka njerëz që vërrtet ndjejnë etje dhe uri për Zotin. Por marrë në përgjithësi shpirti ynë ka etje më tepër për gjëra materiale, gjëra të kota, të cilat asesi nuk e kënaqin shpirtin tonë, sepse sa më i pasur të jetë njeriu aq më tepër kerkon?! Njeriu nuk di të thotë asnjëherë: *Tani kam mjaft pasuri!* Por ai kërkon vazhdimisht më tepër?! Dhe sikur shpirti ynë të ketë etje dhe uri për Zotin, sikur që ka për sport, muzikë, art, garderobë, atëherë do ta kuptonim se atë etje nuk mund ta shuajmë në kafene, rrugë, terene sportive, por në Kishë dhe në këtë mënyrë kishat tona do të ishin të vogla për t'i pranuar të gjithë ata që kishin për të ardhur me shue etjen! Me plotë të drejtë dhe nga përvoja shën Augustini thoshte: *I shqetësuar është shpirti im, derisa nuk qetësohet në ty, o Zot, Hyji im!*

Ungjilli i sotshëm është vazhdimësi nga ungjilli i së dielës së kaluar dhe ka shumë porosi. Nëse na kujtohet të dielën e kaluar Krishti e shpërblen Pjetrin për dëshminë e tij. Ndërsa në vazhdim të dialogut të Krishtit me nxënësit, Krishti paralajmëron vdekjen e vet tragjike. Dhe Pjetri tani paraqitet si mik i Krishtit, më i afërt se nxënësit tjerë, e ndan Krishtin anash dhe i thotë: *Prite Zot, ty një gjë e tillë nuk guxon të ndodhë! Ti nuk guxon ta nënçmosh vetën aq shumë etj etj.* Kjo dëshmonë se edhe pohimin e tij, nga e diela e kaluar, si i thotë Krishti *nuk ta zbuloi mishi e gjaku*, pra, disi as nuk ka qenë i vetëdijshëm se çka është duke thënë? Pra, Pjetri ende nuk është liruar nga botëkuptimi izraelitëve lidhur me Mesinë, i cili duhet ta lirojë popullin e Izraelit, dhe

ta formojë Mbretërinë ku do t'i bashkojë të gjithë bijtë e Izraelit të shpërndarë nëpër botë. Mirëpo unë besoj se Pjetri ia thotë këto fjalë Krishtit me qëllim të mirë. Në anën tjetër, besoj se me reagimin e Krishtit çuditën të gjithë, e jo vetëm Pjetri, sepse kështu ashpër dhe në mënyrë direkte Krishti nuk ka reaguar asnjë herë ndaj askujt: *Largohu prej meje he djallë...* Dhe Krishti nuk ndalet në këtë, por vazhdon me një kërkesë të rëndë: *Kush dëshiron të vjenë pas meje, le ta merr kryqin e vet dhe le të më ndjekë....*

Nga e gjithë kjo mund të nxjerrim këto përfundime: Mund të ndodh edhe në jetën tonë, të planifikojmë gjëra të mira. Mirëpo, ndoshta ato plane nuk përputhën me ato të Zotit. Dhe ne nuk duhet dëshpruar pse nuk janë realizuar planet tona, sepse Zoti është Ai që i realizon planet e veta. Kjo më tepër mund të vjen në shprehje tek sëmundjet që mund të na kaplojnë, vdekja e familjarëve etj. Vërtet lehtë është të jesh besimtar i mirë atëherë kur gjithçka në jetën tonë shkon në rregull. Por besimi ynë në Krishtin dëshmohet atëherë kur vijnë kryqet. Cilat: Mosmarrëveshjet familjare, bashkësho-



rtore, sëmudjet e ndryshme, vdekja e ndonjë anëtarë të familjes etj. Nëse edhe në këto raste të vështira besimi ynë në Krishtin mbetet i forte, dhe të gjitha vështërsitë e jetës i pranojmë me fe, shpresë dhe dashuri, atëherë ne vërtet jemi besimtarë në plot kuptimin e fjalës. Pjetri e ndan Krishtin anash dhe si një mik i tij i mirë e këshillon të kundërshtojë planin e Zotit! Shpesh herë edhe neve na afrohen njerëzit si miq duke na nxitur të mos pajtohemi me të tjerët, na nxisin të bëjmë keq, sepse kështu po bëjnë edhe të tjerët! Pra, është shumë më rëndësi të dijme të dallojmë mikun prej armikut, të refuzojmë edhe më të afërmit tanë nëse na nxisin të bëjmë keq. Si besimtarë të mirë gjithmonë para veprimit duhet të pyesim; a thua kjo puna ime do t'i pëlqejë Zotit, apo jo?

Sot Krishti në ungjill na sjell para një alternativës jetësore: të zgjedhim jetën me Zotin, e cila mund të jetë një jetë me vujatje dhe kryqe, por që sjell fryte të embëla, shpërblimin e madh, dhe në anën tjetër jeta pa Zotin, e cila për momentin do të na duket më e lehtë dhe me më pak vuajtje por që në fund do të na sjellin hidhërimi. Unë besoj se do të jemi aq të zgjuar sa të zgjedhim jetën me Zotin,



sepse tek e fundit qëllimi i lindjes dhe jetës sonë nuk janë kënaqësitë e kësaj bote. Ne nuk kemi lindur që të jetojmë si bota shtazore, vetëm për këtë jetë, por që me jetë dhe me vepra të lëvdojmë Zotin dhe në këtë mënyrë të bëhemi bashkëtrashëgimtarë në Mbretërinë e Tij. Dhashtë Zoti që ashtu edhe të veprojmë. Amen.

Lutja e besimtarëve

Vëllëzër dhe motra, të bashkuar në emër të Krishtit, t'ia paraqesim Krishtit uratat tona, me fe, shpresë dhe dashuri, duke thënë: Dëgjoje, o Zot, lutjen tonë:

- Për Kishën tënde të shpërndarë nepër botë që me sukses të dëshmojë besimin në Ty, Hyj i vërtetë dhe njeri i vërtetë, *të lutemi.*
- Për popullin tonë që të kuptojë se liria e vërtetë dhe ardhmëria e Tij është tek Ti, o Jezu, Shëlbuesi ynë, *të lutemi*
- Për familjet tona, sidomos ato që janë krijuar këtë verë, që në mes të gjitha obligimeve dhe angazhimeve të përditshme, të gjëjnë kohë edhe për uratë, *të lutemi*
- Për rininë tonë që gjithnjë e më tepër vrapon pas aventurave dhe të mirave materiale, që ta kuptojë se vetëm Ti je Rruga, e Vërteta dhe Jeta, *të lutemi.*

O Zot, ne i shprehim dëshirat dhe lutjet tona, por Ti më së miri e di se për çka kemi nevojë. Kështu të bashkuar në emër të Birit tënd, po të lutemi të na japësh ato të mira që na nevojiten për një jetë të vërtetë të krishtere, nëpër Krishtin Zotin tonë. Amen.

Don Kolë ZEFI

Ju prezentojmë meshtarin e ri, Don Jeton Thaçin

Nuk më zgjodhët ju mua, por unë ju zgjodha juve!

Kam lindur në fshatin Dugajevë në vitin 1979, famullia e Gllaviçicës, në një familje të madhe me tipare dhe vlera të larta fetare dhe kombëtare. Shkollën fillore e kam kryer në Drenoc, ndërsa në shtator të vitit 1994 iu përgjigja zërit të Zotit dhe vazhdova seminarin në Prizren. Jemi gjenerata e parë e seminaristëve të Prizrenit. Vërtet në shkollimin e ndoçëm në gjimnazin publik të qytetit *Gjon Buzuku*, por ushqimin dhe kujdesin si seminarist e kishim në seminarin *Lazër Mjeda*. Pas përfundimit të maturës, duke u forcuar edhe më tepër në thirrjen time meshtarake, vazhduam studimet teologjike, bashkë me don Anton Ukaj, në Cremona të Italisë. Pas përgatitjes, mësimi i gjuhës italiane, dhe sistemimit tonë në këtë qytet, që fatmirësisht u bë shumë shpejt, në shtator të vitit 1999 ne filluam studimet në seminarin dioqezan *Santa Maria della pace*. Këto studime me sukses të plotë i përfunduam në këtë verë. Xhakonatin e kemi marrë më 31.VII.2005 nga Mons Mark Sopi, ipeshkvi ynë. Shugurimin meshtarak e patëm me 23.VII.2005 në Potërc dhe Meshën e Parë më 24.VII.2005.

Çka pres nga meshtaria ime? Jam i lumtur, shumë krenar dhe gjithnjë mirënjohës Zotit për të gjitha këto dhurata dhe mundësi që m'i ka dhënë gjatë jetës. Po i cekim disa nga këto dhurata: Dhuratën e jetës, të fesë, me anë të cilës do ta takoj dhe ta jetoj një jetë që është e shortuar në jetën e Jezu Krishtit me anë të pagëzimit dhe të sakramenteve të tjera. Por mbi të gjitha e falënderoj Zotin që në mesin e vëllëzërve të mi, të shokëve të mi më ka ftuar shi mua, duke ma besuar një detyrë me përgjegjësi të madhe, të jem meshtar, dorë e zgjatur e Tij në botë, bashkëpunatori i Tij në shëlbimin e njerëzve, me një fjalë të

jem Krishti i dytë! Është kjo një dhuratë hyjnore për mua si njeri, të cilën unë nuk e kam merituar. Për këtë arsye i kam zgjedhur fjalët e ungjillit: *Nuk më zgjodhët ju mua, por unë u zgjodha juve* (Gjn 15,16). Mendoj se është nder dhe krenari e madhe për familjën dhe famullinë time. Është pasuri edhe për Ipeshkvinë tonë. Pra, mos e dhashtë Zoti që nga meshtaria ime të kërkojë sigurinë e jetës, të vendit të punës. Por me gjithë zemër dëshiroj të jem në shërbim të Zotit, për të mirën e shpirtit të njerëzve. Lirisht mund të them se motoja e jetës sime janë fjalët e të madhit Imzot Pjetër Bogdani: *Fati i popullit tim, është edhe fati im!* Ne po jetojmë në një botë disi të shthurur, ku parimet ungjillore, vlerat morale disi po e humbin vlerën. Në tërë këtë kaos më së tepërmi pëson familja. Ajo është poashtu në krizë gjithnjë e më të madhe. Nga kjo del se rinia, ardhmëria e Kishës dhe e popullit tonë, është e rrezikuar, jo më nga armiqtë e jashtëm, por nga të brendshmit. Dëshiroj që me të gjitha aftësitë e mia intelektuale dhe shpirtërore, duke e shfrytëzuar edhe përvojën time nepër famullitë italiane, t'i ndihmojë rinisë sonë në përgjithësi, e asaj që do të më besohet në shërbim, në veçanti për ta udhëhequr drejt Limanit të amshuar.

Edhe një herë e falënderoj Zotin që më ka ftuar të bëhem meshtar, i falënderoj të gjithë ata miq e dashamirë që më kanë përkrahur në rrugën time drejt meshtarisë, duke filluar nga prindërit dhe familjarët e mi, pastaj eprorët në Prizren, si dhe në Itali. Ju falënderoj ju besimtarë, që me lujtjet tuaja na ndihmoni t'i qendrojmë besnikë Zotit dhe Kishës. Ju ftoj të luteni edhe në të ardhmën për mua dhe për meshtarët. Uroj dhe lutem që në popullin tonë të ketë sa më shumë djel e vajza, që duke e dëgjuar thirrjen e Krishtit: *Eja pas meje!* T'i përgjigjen me gëzim dhe trimëri.

ZOJES CERNAGORE

Harm. D. Nikollë M.



Në Cër-na-go- re kem nji nanë, _____



gjith me-shirë e dash- te- ni, Të haz-nes Zo-tit bi-



te- vi _____ i ka hi- ret në dorë te



vet. Ke-saj bu -kur gjith lul-zi-mit, Ke



Së Lu-mes Zojë e Bi-rit sajë, I
-saj të ma- dhe në ky-vet të do-res I thonë Zo-ja
kjoftë lav- di në mot e jetë. Së Lu-mes Zojë etë



Cër-na- go- _____ res

Me Fëmi në pre-hen

Bi-rit të sajë,

I kjoftë lav-di në



sal le- zet.
jetë. e mot

2. Kqyrni at Fmi me rrez' Hyjnitjet, * Sa lezeçem sytë i siell, Për me dashtun të gjith na niell, * Zemrat gjith po na i grabitë.

3. Nonse Foshnje i madh në dashtni * Po derdhë hire permbi të tanë. Sa nder derte, të vështira janë * këtu shlirohen për gjithë ditë.



Impresum: Ad usum Internum

Boton; Dekanati i Prishtinës

Adresa: Rr. "Rexhep Bislimi" Nr. 50, Ferizaj

E-mail: jetaliturgjike@hotmail.com

Tel.0290/20-041

Shtypi: "ERA" Ferizaj



Stubëll, 1905 - 2005

*100 vjetori i themelimit të famullisë
dhe legalizimit të shkollës së parë shqipe!*

